


SPECIFIKIMET TEKNIKE

Rruga “Hardhishtë-Komunë” Njësia Administrative Gjepale

Bashkia Shijak



Janar, 2026



BASHKIA SHIJAK

KAPITULLI 1

TE DHENAT E PERGJITHSHME

1.1	Te pergjitheshme	3
1.2	Zevendesimet	3
1.3	Dokumentat dhe vizatimet.....	3
1.4	Kostot e Sipermarresit per mobilizim dhe punime te perkoheshme	3
1.5	Hyrja ne sheshin e ndertimit.....	3
1.6	Furnizimi me uje	4
1.7	Furnizimi me energji elektrike	4
1.8	Piketimi i punimeve	4
1.9	Fotografite e sheshit te ndertimit.....	5
1.10	Bashkepunimi ne zone	5
1.11	Mbrojtja e punes dhe e publikut.....	5
1.13	Transporti dhe magazinimi i materialeve.....	6
1.14	Sheshi per magazinim	6
1.15	Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet siç eshte zbatuar)	6
1.16	Pastrimi perfundimtar i zones	7



BASHKIA SHIJAK

1.1 Te pergjitheshme

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesuese te detajeve te dhena ne Kushtet e Kontrates.

1.2 Zevendesimet

Zevendesimi i materjaleve te specifikuara ne Dokumentin e Kontrates do te behen vetem me aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve ne se materjali i propozuar per tu zevendesuar eshte i njejte ose me i mire se materjalet e specifikuara ; ose ne se materjalet e specifikuara nuk mund te sillen ne sheshin e ndertimit ne kohe per te perfunduar punimet e Kontrates per shkak te kushteve jashte kontrollit te Sipermarresit. Qe kjo te merret ne konsiderate, kerkesa per zevendesim do te shoqerohet me nje dokument deshmi te cilesise, ne formen e kuotimit te certifikuar dhe te dates se garancise te dorezimit nga furnizuesit e te dy materjaleve, si te materialit te specifikuar ashtu edhe te atij qe propozohet te ndryshohet.

1.3 Dokumentat dhe vizatimet

Sipermarresi do te verifikojte te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet te treguar ne Vizatimet, Grafiket,ose te dhena te tjera dhe Punedhenesi nuk do te mbaje pergjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtesoje Sipermarresin nga pergjegjesia per pune te pakenaqeshme. Sipermarresi do te marre persiper te gjitha pergjegjesine ne berjen e llogaritjeve te madhesive, llojeve dhe sasive te materialeve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga Punedhenesi ne se gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

1.4 Kostot e Sipermarresit per mobilizim dhe punime te perkoheshme

Do te kihet parasysh qe Sipermarresit nuk do ti behet asnje pagese mbi cmimet njesi te kuotuar per kostot e mobilizimit d.m.th. per sigurimin e transportit, drite, energjine, veglat dhe pajisjet,ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit, rrugeve te hyrjes, te komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, punen, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, pajisje dhe materjale, ose per kujdesin mjeksor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjeter, lehtesi, gjera, ose materjale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

1.5 Hyrja ne sheshin e ndertimit

Sipermarresi duhet te organizoje punen per ndertimin, mirembajen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose cdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me



BASHKIA SHIJAK

zbatimin e punimeve. Çvendosja do të përfshijë pershtatjen e zones me cdo rrugë hyrje dhe se paku me shkallë sigurie, qendrueshmëri dhe të kullimit të ujërave sipërfaqesore të njëjta me ato që ekzistonte përpara se Sipërmarresi të hynte në Shesh.

1.6 Furnizimi me ujë

Uji, që nevojitet për zbatimin e punimeve, do të merret nga rrjeti kryesor nepermjet një matesi në piken me të afërt të mundshme. Sipërmarresi do të shtrijë rrjetin e vet të perkoheshëm të tubacioneve. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot për këto do të paguhën nga Sipërmarresi. Në rastet kur nuk ka mundësi lidhje me rrjetin kryesor, Sipërmarresi duhet të bëjë vetë përpjekjet për furnizimin me ujë higjienikisht të pastër dhe të pijshëm për punetoret dhe punimet.

1.7 Furnizimi me energji elektrike

Sipërmarresi do të bëjë përpjekjet dhe me shpenzimet e tij për furnizimin me energji elektrike në kantier, si me kontraktim me KESH – in, kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal janë të mundura, ose duke parashikuar gjeneratorin e vet për të përbushur kërkesat.

1.8 Piketimi i punimeve

Sipërmarresi, me shpenzimet e tij duhet të bëjë ndërtimin e modinave dhe të piketave sic kerkohet, në përputhje me informacionin bazë të Punedhënesit, dhe do të jetë përgjegjës i vetëm për përpikmerinë.

Sipërmarresi do të jetë përgjegjës për të kontrolluar dhe verifikuar informacionin bazë që i është dhënë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lehtësohet nga përgjegjësia e tij nëse një informacion i tillë është i mangët, jo autentik ose jo korrekt. Ai ndërkohë do të jetë subjekti që do të kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhënesi, dhe në asnjë rast nuk i jepet e drejta të bëjë ndryshime në vizatimet e kontratës, për asnjë lloj kompensimi për korrigjimet e gabimeve ose të mangësive. Sipërmarresi do të furnizojë dhe mirëmbajë me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale të tjera të tilla dhe të japë asistencë nepermjet një stafi të kualifikuar sic mund të kerkohet nga Punedhënesi për kontrollin e modinave dhe piketave.

Sipërmarresi do të ruajë të gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, të bërë ose të vendosura gjatë punës, të mbulojë koston e rivendosjes së tyre nëse ato demtohen dhe të mbulojë të gjitha shpenzimet për ndreqjen e punës së bërë jo mirë për shkak të mosmirëmbajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim të këtyre pikave të vendosura, modinave dhe piketave.

Përpara cdo aktiviteti ndërtimor, Sipërmarresi do të ketë linjat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike të vendosura në terren, të drejten e kalimit të qartë dhe të sheshuar, gati për fillimin e punimeve. Çdo punë e bërë jashtë akseve, kuotave dhe kufijve të treguara në vizatime ose të mosmiratuara nga Punedhënesi nuk do të paguhet, dhe Sipërmarresi do të mbulojë me shpenzimet e tij gërmimet shtesë gjithmone nën drejtimin e Mbikqyresit të Punimeve.



BASHKIA SHIJAK

1.9 Fotografite e sheshit te ndertimit

Sipermarresi duhet te beje forografi me ngjyra sips udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve ne vendet e punes per te demonstruar kushtet e sheshit perpara fillimit , progresin gjate punes se ndertimit dhe mbas perfundimit te punimeve. Nuk do te behen pagesa per fotografimin e kantierit te punimeve pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbulohen nen koston administartive te Sipermarresit.

1.10 Bashkepunimi ne zone

Ndertimi do te behet ne zona te kufizuara. Sipermarresi duhet te kete vecanerisht kujdes ne:

- a) nevojen per te mirembajtur sherbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit per banoret dhe tregetaret qe jane ne zone, gjate periudhes se ndertimit.
- b) prezencen e mundeshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te koordinohet puna

E gjithë puna, do te behet ne nje menyre te tille, qe te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithë pajisjeve te mundeshme per ndonje Kontraktor tjetër dhe punetoreve te tij, stafin e Punedhenesit si edhe te cdo punojnjesi qe mund te punesohet ne zbatim dhe/ose punimet ne zone ose prane saj per cdo objekt qe ka lidhje me Kontraten ose cdo gje tjetër.

Ne pregatitjen e programit te tij te punes, Sipermarresi gjate gjithë kohes do te beje llogari te plote dhe do te koeporoje me programin e punes se Kontraktoreve te tjere, ne menyre qe te shkaktoje nje minimum interference me ta dhe me publikun.

1.11 Mbrojtja e punes dhe e publikut

Sipermarresi do te mare masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar dhe te jetes publike si edhe te pasurive ne dhe rreth sheshit te ndertimit. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikushme, kodeve te ndertesave dhe te ndertimit do te respektohen. Makinerite, pajisjet dhe cdo rrezik do te kqyren ose eliminohen ne perputhje me masat paraprake te sigurimit.

Gjate zbatimit te punimeve Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te vendosi dhe te mirembaje gjate nates pengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet. Sipermarresi duhet te siguroje pengesa te pershtateshme, shenja me drite te kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues ne te gjitha vendet ku punimet mund te shkaktojne crregullime te trafikut normal ose qe perbejne ne ndonje menyre rrezik per publikun.



BASHKIA SHIJAK

1.12 Mbrojtja e ambientit

Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjitha veprimet e mundshme per te siguruar qe ambjenti lokal i sheshit te ruhet dhe qe linjat e ujit, toka dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera. Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Mbikqyresi i Punimeve, mund te coje ne nderprerjen e kontrates.

1.13 Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i cdo materiali nga Sipermarresi do te behet me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjitha ngarkesa te jete e siguruar. Ndonje makine qe nuk ploteson kete kerkese ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqet nga kantjeri. Te gjitha materialet qe sillen nga Sipermarresi, duhet te stivohen ose te magazinohen ne menyre te pershtateshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe ne dispozicion, per tu kontrolluar nga Mbikqyresi i Punimeve ne cdo kohe.

1.14 Sheshi per magazinim

Sipermarresi duhet te beje me shpenzimet e tij marrjen me qira ose blerjen e nje terreni te mjaftueshem per ngritjen e magazinave me shpenzimet e tij.

1.15 Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet sic eshte zbatuar)

Sipermarresi duhet te pergatise vizatimet per te gjitha punimet “sic jane faktikisht zbatuar” ne terren. Vizatimet do te behen ne nje standart te ngjashem me ate te vizatimeve te Kontrates.

Gjate zbatimit te punimeve ne kantier, Sipermarresi do te ruaje te gjitha informacionin e nevojshem per pergatitjen e “Vizatimeve sic eshte zbatuar”. Do te shenoje ne menyre te qarte vizatimet dhe te gjitha dokumentat e tjera te cilat mbulojne punen e vazhdueshme te perfunduar, material i cili do te jete i disponueshem ne cdo kohe gjate zbatimit per Menaxherin e Projektit. Keto vizatime do te azhornohen ne menyre te vazhdueshme dhe do t'i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve cdo muaj per aprovim, pasi Punimet te kene perfunduar, sebashku me kopjen perfundimtare. Materiali mujor do te dorezohet ne kopje leter.

Vizatimet e riprodhuara do te perfshijne pozicionin dhe shtrirjen e te gjitha konstruksioneve mbajtese te lena gjate germimeve dhe vendosjen ekzakte te te gjitha sherbimeve qe jane ndeshur gjate ndertimit. Sipermarresi gjithashtu duhet te pergatise seksionet e profilit gjatesor te rishikuar, pajisur me shenimet qe tregojne shtresat e tokes qe hasen gjate te gjitha punimeve te germimit.

Si perfundim, kopjet e riprodhuara te Vizatimeve “ sic eshte zbatuar” do t'i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve per aprovim. Vizatimet “sic eshte zbatuar” ,te aprovuara, do te behen prone e Punedhenesit.

Nuk do te behen pagesa per berjen e Vizatimeve “sic eshte zbatuar” dhe Manualeve, pasi kosto e tyre eshte parashikuar te mbulohet nga shpenzimet administrative te Sipermarresit.



BASHKIA SHIJAK

1.16 Pastrimi perfundimtar i zones

Ne perfundim te punes, sa here qe eshte e aplikueshme Sipermarresi, me shpenzimet e tij, duhet te pastroje dhe te heqe nga sheshi te gjitha impiantet ndertimore, materialet qe kane tepruar, mbeturinat, skelerite dhe ndertimet e perkoheshme te cdo lloji dhe te lere sheshin e tere dhe veprat te pastra dhe ne kondita te pranueshme. Pagesa perfundimtare e Kontrates do te mbahet deri sa kjo te realizohet dhe pasi te jepet miratimi nga Mbikqyresi i Punimeve.

1.17 Provat

Ky seksion perfqeson procedurat e kryerjes se provave per materialjet me qellim qe te siguroje dhe perputhje me kerkesat e Specifikimeve.

Tipi dhe Zbatimi i Provave

Do te kryhen provat e meposhtme:

- Permbajtja e Ujit
- Densiteti Specifik
- Indeksi i Plasticitetit
- Densiteti ne gjendje te thate (Metoda e Zevendesimit me Rere)
- Shperndarja Sipas Madhesise se Grimeve (Sitja)
- Proktori i Modifikuar dhe Normal
- CBR (California Bearing Ratio)
- Provat e Bitumit
- Provat e Betonit (Thermimi i Kampioneve)

Standartet per Kryerjen e Provave

Te gjitha provat do te behen ne perputhje me metodat standarte shqiptare ose me te tjera nderkombetare te aprovuara.

Marrja e Kampioneve edhe Numri i Provave

Metoda e marrjes se kampioneve do te jete sic eshte specifikuar ne metodat e aplikueshme te marrjes se kampioneve dhe te kryerjes se provave ose sic udhezohet nga Mbikqyresit te Punimeve.

Frekuenca e kryerjes se provave do te perputhet me treguesit ne Specifikimet Teknike dhe nese nuk gjendet atje, do te jepet nga Mbikqyresit te Punimeve. Marrja e ndonje kampioni shtese mund te udhezohet nga Mbikqyresit te Punimeve.

Ene te tilla si canta, kova e te tjera, do te jepen nga Sipermarresi. Marrja e kampioneve do te kryhet nga Sipermarresi ne vendet dhe periudhat qe udhezohen nga Mbikqyresit te Punimeve. Marrja, transportimi e sjellja e tyre ne laborator do te behet nga Sipermarresi.



BASHKIA SHIJAK

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KAPITULLI 2

TE DHENAT KRYESORE TE RRUGES “HARDHISHTE - KOMUNE ”, NJ. ADMINISTRATIVE GJEPALE

- 2.1 TE PERGJITHSHME
- 2.2 GJENDJA FIZIKE
- 2.3 POZICIONIMI I RRUGES
- 2.4 NDERYHRJET E PARASHIKUARA DHE SEKSIONI TIP



BASHKIA SHIJAK

2.1 Të përgjithshme

Rruga “Hardhishte - Komunë” ndodhet në Nj. Administrative Gjepale dhe përbën arterien kryesore të njësisë pasi shërbën për lidhjen e 6 fshatrave të kësaj njësie me rrugën kryesore Plepa-Ndroq si dhe me Bashkinë Shijak. Rruga ka rëndësi parësore për banorët e zonës pasi është I vetmi segment që lidh këtë zonë të banuar me qytetin e Shijakut, Durrësit dhe Tiranës duke u shërbyer në këtë mënyrë rreth 6000 banorëve.




Figure 1 Në këtë imazh paraqiten rrugët e Nj. A. Gjepale, të emërtuara me numra ku: 1-Rr “Hardhishtë – Komunë”; 2- Rr “Shijak-Komunë”; 3- Rr “Likesh-Komunë”; 4- Rr “Kënetë-Komunë”; 5- Rr “Shetel -Komunë”; 6- Rr “Eminas i Vogël-Komunë”; 7-Rr “Cizmeli- Komunë”

Gjatësia totale e kësaj rruge nga piketa SC-01 deri në piketën SC-149 është 2960 ml. Asfaltimi I rrugës është kryer para 15 vitesh dhe nga atëherë janë aplikuar rikonstruksione të pjesshme të saj.

2.2 Gjendja Fizike

Rruga paraqitet me strukturë të amortizuar thuajse në të gjithë gjatësinë e saj. Shtresat asfaltike janë të konsumuar dhe të plasaritura. Në segmente të veçanta të rrugës, amortizimi ka arritur deri në shtresën e nën-bazës ku për pasojë edhe cakëlli është gërryer. Rruga kufizohet nga dy anët e saj nga kanale të kullimit të ujrave sipërfaqësor të cilët aktualisht paraqiten pjesërisht të mbuluar.

Projekti I rikonstruksioni të rrugës parashikon , riasfaltimin e të gjithë trupit të rrugës, lirimi i kanaleve për drenimin e ujrave sipërfaqësor, vendosje e tombinove në gjatësitë dhe përcaktimet e projektit, plotësimin me sinjalistikë përkatëse jo-ndricuese të rrugës, mure mbajtës etj.

Gjatësia totale e rrugës është 2960ml dhe për efekt të ndryshimeve në paketën e shtresave që do të rikonstruktohen si dhe të gjërësisë, projekti e ndan trupin e



BASHKIA SHIJAK

rrugës sipas tre seksioneve përkatësisht "Seksion Tërthor 1", "Seksion Tërthor 2" dhe "Seksion Tërthor 3".

ST-1. Sipërfaqet e rrugës të cilat paraqesin problematikat e konsumimit vetëm të shtresave asfaltike dhe ku amortizimi ka arritur deri në nën-bazën e rrugës por pa e dëmtuar atë.

ST-2. Në rastin kur amortizimi I strukturës së rrugës ka përfshirë edhe nën-bazën e rrugës duke gërryer shtresat e makadamit të cakëllit, ndërhyrjet e parashikuara janë përcaktuar të realizohen sipas prerjes tërthore paraqitur në "Seksion Tërthor 2", ku përveç shtresave asfaltike, parashikohet edhe rikonstruksioni I nën-bazës së trupit të rrugës me 2 shtresa 10cm cakëll malik u $d_{max} \leq 1/3 H_{shtresës}$.

ST-3. Në segmentet të cilat në project specifikohen si "Seksion Tërthor 3", ndërhyrja parashikohet e njëjtë si paketa e shtresave në "Seksionin tërthor-1" pra duke ndërrhyrë vetëm në rikonstruksionin e shtresave të sipërme rrugore, ndërkohë që gjërësia e trupit të rrugës është parashikuar 4.20m asfalt. Gjatësia totale 390 ml. Sipërfaqja 1,725.00m². Në këtë seksion të rrugës është parashikuar edhe betonimi I bankinave

Tombinot. Përjashtojë konsumimin e shtresave asfaltike të rrugës për shkak edhe të periudhës së gjatë të shërbimit, amortizimi I strukturës së rrugës ka ardhur edhe sipasojë e pamundësisë së drenimit të ujërave atmosferikë për shkak të kanaleve pjesërisht të bllokuara në dy anët e saj. Gjithashtu konstatohet që në segmente të caktuara (SC-125 ÷ 129), amortizimi ka ardhur për shkak të mungesës së tombinove, ose seksionit tërthor të tyre I pamjaftueshëm.

Muri mbajtës. Gjithashtu, në piketën SC-146 deri SC-147 që përkon edhe me rrugën hyrëse të shkollës 9-vjecare të njësisë, me qarkullim të vazhdueshmë, në njërin anë të rrugës evidentohet një skarpatë e papërfortuar si dhe e paqëndrueshme me rrezik shembje.

Sa I takon pajisjes me **sinjalistikën rrugore** ku përfshihen sinjalistika horizontale dhe vertikale, konstatohet që është e pamjaftueshme ose mungon tërësisht cka bën që në të gjithë gjatësinë e rrugës të mungojë informacioni lidhur me shpejtësinë e lejuar, njoftimin e përdoruesve të rrugës për rrezeqe, evidentimin e ndalesave apo përparësive në rrugë etj.

Për këto arsye, rikonstruksioni I këtijë aksi është parashikuar të realizohet I plotë në përputhje me të gjitha standartet e projektimit dhe rregullat e qarkullimit rrugor për të garantuar sigurinë në lëvizje dhe jetëgjatësinë e rrugës.

Mëposhtë paraqitet në foto gjendja ekzistuese e rrugës referuar piketave të emërtuara në projektin e zbatimit.



BASHKIA SHIJAK




Figure 2 Gjendja ekzistuese nga km0 +600 m



Figure 3 Gjendja ekzistuese nga km0 +940m



Figure 4 Gjendja ekzistuese nga km1 +200m



BASHKIA SHIJAK



Figure 5 Gjendja ekzistuese nga km1 +660m



Figure 6 Gjendja ekzistuese nga km2 +320m



Figure 7 Gjendja ekzistuese nga km2 +380m



BASHKIA SHIJAK



Figure 8 Gjendja ekzistuese nga km2 +540m



Figure 9 Gjendja ekzistuese nga km2 +740m



Figure 10 Gjendja ekzistuese nga km2 +840m



BASHKIA SHIJAK

2.3 Pozicionimi I rrugës




Figure 11 Gjendja ekzistuese nga km0 +340m deri km0+880m

Koordinatat sipas Asig Geoportal:

Pika e fillimit

GRS 80

(λ): 19° 34' 08.1686"

(φ): 41° 18' 27.2237"

UTM Zone 34N

E: 380204.88

N: 4573887.94

Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4

E: 4380287.50

N: 4575849.45

KRGJSH

E: 463901.39

N: 4574819.82

Pika e mbarimit

GRS 80

(λ): 19° 35' 51.2698"

(φ): 41° 18' 21.9538"

UTM Zone 34N

E: 382599.72

N: 4573686.29

Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4

E: 4382683.32

N: 4575647.71

KRGJSH

E: 466298.98

N: 4574645.73



BASHKIA SHIJAK

2.4 Ndëryhrjet e parashikuara dhe seksionet tip

Sipërfaqja e shtresës së re asfaltike është = **15 860 m²**.

Punimet që parashikohen të kryhen në të gjithë trupin e rrugës përfshijnë:

1. Skarifikim e shtresave asfaltike të konsumuara;
2. Hapje/nivelimi/ngjeshja e cakëllit në gropat e hapura në rrugë me stabilizantit + spërkatje me emulzion bituminoze + binder 6 cm + asphalt 4 cm, referuar paketës së shtresave Seksionit Tërthor -1 dhe Seksion Tërthor -3
3. Hapje/nivelimi/ngjeshje e cakëlli në 2 shtresa 10cm+10cm + stabilizantit 15cm+ spërkatje me emulzion bituminozë në të gjithë trupin e rrugës + binder 6 cm + asphalt 4 cm - referuar paketës së shtresave në “Seksioni Tërthorë -2”
4. Pastrimi i kanaleve kullues në të dy anët e rrugës dhe formatimi me beton I tyre sipas në ST-3 nga km2+860m deri km2+880m sipas përcaktimeve në project për të mundësuar lidhjen me tombinot ekzistuese
5. Vendosjen e tombinove me diametra dhe gjatësi sipas përcaktimeve të projektit duke mundësuar drenimin e pa-penguar të trupit të rrugës.
6. Aplikimin e dhe sinjalistikës rrugore përfshirë atë vertikale dhe horizontale, jo-ndricuese për rritjen e sigurisë në qarkullim për përdoruesit e rrugës;
7. Realizimin e bankinave prej betony në segmentet e ST-3, në të dyja anët e rrugës. Në ST-1 dhe ST-2, kufizuesit e trupit të rrugës përbëhen nga bordure betony ekzistuese;
8. Realizimin e murit mbajtë gravitacional butobetoni nga km2+900m deri km2+920m;

Në segmentet **ST-1**, sipërfaqet e asfaltit ekzistues parashikohen të frezohen 30-40 mm ndërkohë që sipërfaqet e gropave ku amortizimi nuk ka arritur në nën-bazën e rrugës parashikohen të mbushen stabilizant + spërkatje me emulsion bituminoz. Paketa e shtresave parashikon 4 cm asphalt + 6 cm binder + 15 cm stabilizant + spërkatje bituminoze (në gropat që paraqiten në këtë seksion). Gjatësia totale 2065 ml. Gjërësia e rrugës 5.50 m. Sipërfaqja 11,357.50m².




Figure 12 Seksioni tërthor -1

ST-2, ku përveç shtresave asfaltike, parashikohet edhe rikonstruksioni I nën-bazës së trupit të rrugës me 2 shtresa 10cm cakëll malik u $d_{max} \leq 1/3 H_{shtresës}$.



BASHKIA SHIJAK

Paketa e shtresave parashikon 4 cm asfalt + 6 cm binder + 15 cm stabilizant + spërkatje bituminoze (në të gjithë gjatësinë e trupit të rrugës ku përcaktohet ST-2). Gjatesia totale 505ml . Ndërhyrjet sipas ST-2 parashikohen në piketat SC-46 ÷ 48, L=40ml; SC-55 ÷ 62, L=140ml; SC-80 ÷ 88, L= 155 ml SC-113 ÷ 118, L=100ml; SC-125 ÷ 129, L= 70ml. Gjërësia e rrugës 5.50 m. Sipërfaqja 2,777.50m².

SEKSION TËRTHOR TIP-2

SC-46 ÷ SC-48 : SC-55 ÷ SC-62

SC-80 ÷ SC-88 : SC-113 ÷ SC-118

SC-125 ÷ SC-129

Sh. 1:50




Figure 13 Seksioni tërthor -2

ST-3. Parashikon rikonstruksionin e shtresave të sipërme rrugore, ndërkohë që gjërësia e trupit të rrugës në project përcaktohet 4.20m asfalt. Gjatësia totale 390 ml. Sipërfaqja 1,725.00m². Në këtë seksion të rrugës është parashikuar edhe betonimi I bankinave me beton C20/25, nga km2+580m deri në km2+960m. Gjithashtu nga km2+840m deri km2+2+880 m është parashikuar formatimi me beton I kanalit kullues në një rën anë të rrugës

SEKSION TËRTHOR TIP- 3

Sh. 1:50




Figure 14 Seksioni tërthor -3



BASHKIA SHIJAK

SHENJA LAJMERUESE

LAJMERIM PER NDERPRERJE NGA RRUGE DYTESORE, KTHESAT E KURBEZUARA, FEMIJET, KEMBESORET DHE PER NDALJE/DHENIE RRUGE

trekendeshi: e kuqe reflektuese
sfondi: i zi
Simboli: e bardhe reflektuese
Shenja :e zeze reflektuese
60 cm



SHENJA NDALUESE

shenjat per kufirin e shpejtesise dhe ndalim parakalimin

rrethi: e kuqe reflektuese

Shenja :e zeze reflektuese
60 cm



SHENJA DETYRUESE

Anet & Shigjetat: E bardhe reflektuese
Sfondi: blu reflektuese KI 2




SHENJA PLOTESUESE

SHENJA E KTHESES NE NJE DREJTIM & DY DREJTIME

Shenja : e bardhe reflektuese
Sfondi: e zeze



SHENJA INFORMUESE



SHENIM: Shenjat rrugore per nga forma, madhesia, ngjyra reflektiviteti duhet te jene sipas Kodit Rrugor te Republikes se Shqiperise
Materiali praparefektiv duhet te kete jetegjatesi 10vjet per Clasin 2 dhe 7 vjet per Clasin 1
Simboli brenda shenjes rrugore duhet te jete i realizuar me boje te trajtuar me pjekje e cila nuk humbet treguesit praparefektiv
Shenja rrugore realizohet me llamarine çeliku e cila lyhet me boje opake kundrandra korozionitdhe trajtohet me pjekje.

Figure 18 Sinjalistika vertikale në rrugë